



Foto: Majlinda Dedaj

**David Cuka: “Duaje veten dhe mbroji ngjyrat e tua, pavarësisht nga vështirësitë me të cilat përballësh. Çdo person ka të drejtën të jetojë i lirë, pa u paragjykuar!”**

***David Cuka, një 31-vjeçar nga Tirana, ka hyrë në histori si i pari person transgjinnor që ka pranuar publikisht identitetin e tij gjinor në Shqipëri. Përmes punës si fotoreporter dhe gazetar dokumentarësh që prej vitit 2016, Davidi ka hedhur dritë mbi komunitetet e margjinalizuara, veçanërisht mbi komunitetin transgjinnor, duke rritur zërat e tyre dhe duke u shprehur në mbrojtje të të drejtave të tyre. Në këtë intervistë ai reflekton mbi vështirësitë e papritura që ka hasur në një shoqëri ku ndikimi i stereotipave dhe diskriminimit është ende mjaft i madh. Ai iu bashkua fushatës “Imagine” (Imagjino!) të UN Women që synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe t’u kundërvihet stereotipave kulturorë dhe diskriminimit me bazë gjinor në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor.***

“Si person transgjnor, jam përballur me kërcënime të shumta nga individë, si edhe një numër pengesash, që nga problemet me aksesin në terapi hormonale deri tek ato lidhur me mbrojtjen nga organet e zbatimit të ligjit. Në mars të vitit 2022 isha objekt i një sulmi fizik të motivuar nga transfobia, dhe personi që më sulmoi nuk u dënua. Pas dy vitesh hetime, çështja e tij u pushua. Mungesa e mbështetjes institucionale dhe ajo e pranimit nga shoqëria më ka bërë të ndihem i izoluar dhe vulnerabël, dhe ka ndikuar edhe në mirëqenien time mendore dhe emocionale. Unë nuk dilja dot nga shtëpia, madje as nuk mund të përdorja transportin publik; këtë vështirësi e kam edhe sot. Sa herë që më sulmojnë fizikisht dhe sa herë që përjetoj bullizëm dhe sulme në rrjetet sociale, ato ndikojnë tek unë emocionalisht. Përveç kësaj, mungesa e aksesit në terapi hormonale, që është aq e rëndësishme, e përkeqëson edhe më situatën.

Me fjalë të tjera, të jesh person transgjnor në një shoqëri patriarkale si ajo e Shqipërisë është njësoj si të mos ekzistosh. Mua ende nuk më pranojnë në punë pikërisht për këtë arsye, megjithëse askush nuk ta thotë këtë argument drejtpërdrejt në sy. Të jesh artist është e vështirë kudo, por të jesh artist dhe në të njëjtën kohë transgjnor, është njëqind herë më e vështirë.

Megjithatë, unë e përdor artin tim për të avokuar për barazi dhe për t'u dhënë zë komuniteteve të marginalizuara. Unë përpiqem të krijoj një platformë për dialog dhe mirëkuptim, një platformë ku sfidohen stereotipat dhe promovohet pranimi. Në qendër të vizionit tim për një shoqëri më përfshirëse janë të drejtat dhe mundësitë e barabarta për të gjithë individët, pavarësisht nga identiteti gjnor i tyre.

Unë dëshiroj t'i shoh personat transgjnorë në të gjitha fushat e mundshme të jetës, përfshirë në media. Duke pasur akses në media dhe duke arritur pavarësi ekonomike, ata do të kenë më shumë mundësi për të komunikuar dhe për t'i bërë njerëzit më të ndërgjegjësuar lidhur me të drejtën e tyre për të jetuar të lirë dhe pa u paragjykuar. Është shumë e rëndësishme që të pranohet se prania në media jo vetëm që i jep zë vështirësive personale, por edhe nxit mirëkuptimin dhe empatinë në të gjithë shoqërinë në përgjithësi. Për mua, dalja hapur në media vërtet ka sjellë vështirësitë e veta, por ajo shënon edhe një hap të rëndësishëm drejt lirisë dhe çlirimit personal. Është shumë e rëndësishme të pranohet se edhe një informacion i vetëm mund të bëhet shkas për të sjellë ndryshim në jetët tona. Ajo që i shtyn personat transgjnorë që të dalin hapur, qoftë publikisht apo në mjediset ku ndihen të sigurt, është prania e disa njerëzve që janë të gatshëm t'i mbështesin në rrugën e tyre. Për këtë arsye, mesazhi im është: duaje veten, dhe mbroji ngjyrat e tua, pavarësisht nga vështirësitë me të cilat përballlesh.

Ëndrra ime është që një ditë secili prej nesh të ketë të drejta të barabarta dhe që ne të mos lëndohemi apo persekutohemi vetëm sepse jemi aktivistë. Dhuna nuk është e vetmja zgjidhje. Dashuria është e vetmja forcë që na duhet.”